



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Pukë, më 10.10. 2025

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBBIMIN CIVIL**

SPECIALIST I TATIM -TAKSAVE

**Lloji i diplomës “Ekonomi” , ‘Administrim Biznes, niveli minimal i
diplomës “Bachelor”, ose “Master Profesional**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Vendimin nr.503, datë 01.8.2024 Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, VKM nr.108, datë 26.02.2014 “Për Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”; Vendimit nr. 13, datë 23.12.2024 të kryetarit të Bashkisë Pukë “Për miratimin e organigramës dhe strukturës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2025”, VKB nr. 05, datë 25.02.2025, ‘Për miratimin e Nivelit të Pagave të Administratës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara për vitin 2025”, Vendimit nr.12, datë 25.07.2025 “Për Miratimin e Planit Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil për vitin 2025 në Bashkinë Pukë”, Vendimit nr. 13, datë 25.07.2025 ‘Për shpalljen e vendeve të lira në administratën e Bashkisë Pukë”, Bashkia Pukë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- **1 (një) Specialist i tatim-taksave në Sektorin e Tatim-Taksave, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës IV-3 .**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!
Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 27.10.2025	Lëvizje paralele
--	-------------------------

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 30.10.2025	Pranim në shërbimin civil
--	----------------------------------

- Administron dokumentacionin e subjekteve taksapaguese dhe kryen në vazhdimësi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur nga ana e subjektit, konform ligjeve në fuqi.
- Inspekton objektet dhe subjektet taksapaguese për pagimin e taksave si dhe tregun e lirë dhe merkaton.
- Identifikon nepermjet inspektimeve në terren subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Pukë.
- Përgatit aktdetyrimet për çdo subjekt taksapagues me faturat përkatëse dhe organizon punën për shpërndarjen e tyre brenda afatit të përcaktuar e përgjigjet për saktësinë e tyre.
- Përgatit dokumentet e sekuestrimit dhe në bashkëpunim me Policinë bashkiake ekzekuton aktet e sekuestrimit dhe konfiskimit.
- Drejton shitjen e mallrave të sekuestruara.
- Trajton gjithë ankesat që kanë të bëjnë me verifikimet e përmasave të pronave, destinacionit të përdorimit të pronave kur ato i adresohen nga përgjegjësi i sektorit.
- Ndjek debitorët për taksën e papaguar dhe përgatit kujtesorët për taksapaguesit e prapambetur.

- Orienton dhe ndjek procedurën e regjistrimit të këtyre subjekteve dhe pagimin e detyrimeve nga ana e tyre si në momentin e regjistrimit për herë të parë ashtu edhe në vazhdim.
- Me urdhër të eprorit direkt merr masa shtrënguese në bashkëpunim me Policinë Bashkiake për regjistrimin e subjekteve të indentifikuara por të pa regjistruara brenda afateve ligjore.
- Nxjer urdherat e kontrollit, sekuestrot dhe i paraqet per miratim tek eprori direkt.

I-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv ;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, në Inxhinieri ndërtimi, urbanistikë ose arkitekturë.
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- b. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c. Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Pukë ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b. <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i. Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka masë disiplinore në fuqi.

- j. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 27.10.2025 .

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **29.10.2025** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Pukë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, <https://akpa.gov.al/vlp-njesite-e-qeverisjes-vendore/2/>, si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Pukë <https://bashkiapuke.gov.al/> listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”
- Ligjin Nr.119/2014 të miratuar me datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” i ndryshuar
- Ligji nr Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezulttit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Pukë do të shpallë fituesit në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, <https://akpa.gov.al/vlp-njesite-e-qeverisjes-vendore/2/>, si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Pukë <https://bashkiapuke.gov.al/>

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Inxhinieri ndërtimi.
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- b. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c. Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b. <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c. Fotokopje të diplomës;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.10.2025 , në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Pukë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **02.11.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Pukë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, <https://akpa.gov.al/vlp-njesite-e-qeverisjes-vendore/2/> listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”
- Ligjin Nr.119/2014 të miratuar me datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;

- Ligji Nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” i ndryshuar
- Ligji nr Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www%.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al) , <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Pukë do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” <https://akpa.gov.al/vlp-njesite-e-qeverisjes-vendore/2/> dhe në faqen e saj zyrtare <https://bashkiapuke.gov.al/>

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI

KRYETARI I BASHKISË

RROK DODAJ